



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 30.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik NSHT “VIKTORY COM” Pjeter Qerimi B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit**”, Nr. i prokurimit- 632-23-636-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-007 -511, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** dhe nuk do të shqyrtohet Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik NSHT “VIKTORY COM” Pjeter Qerimi B.I, e dt.30.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit**”, Nr. i prokurimit- 632-23-636-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-007-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 26.05.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 26.05.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.30.05.2023, Operatori Ekonomik NSHT “VIKTORY COM” Pjeter Qerimi B.I, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “**Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit**”, Nr. i prokurimit- 632-23-636-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-007-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.06.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Për aktivitetin prokurimit: **“Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit”**, Nr. i prokurimit- 632-23-636-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-007-521, ju keni konkurruar si konzorcium NSHT “VIKTORY COM” Pjeter Qerimi B.I & Company Eskavatori Sh.p.k & Marisa Sh.p.k, ku lideri sipas marrëveshjes është Company Eskavatori Sh.p.k., kurse kërkesa për rishqyrtim është parashtruar nga ana juaj si anëtarë i konzorciumit .

Në autorizimin e Company Eskavatori Sh.p.k si lideri i konzorciumit NSHT “VIKTORY COM” Pjeter Qerimi B.I & Company Eskavatori Sh.p.k & Marisa Sh.p.k, ju z.Qerimi, jeni autorizuar që në emrin dhe interesin konzorciumit të nënshkruani të gjitha paramasat dhe parallogaritë, aplikacionet, marrëveshjet dhe të gjitha dokumentet e tjera të tilla që mund të jenë të nevojshme për dorëzimin e tenderit të sipër përmendur. Gjithashtu autorizoheni që të veproni përgjatë të gjitha fazave të tenderimit, duke përfshirë nënshkrimin e kontratës së sipër përmendur dhe pagesat, por në këtë autorizim, nuk ceket askund, që ju jeni i autorizuar në emër të grupit të parashtroni kërkesë për rishqyrtim apo ankesë në OSHP-ë, për aktivitetin e sipërpërmendur të prokurimit .



TTULLI: Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - Pjesë e qarkores së qytetit

Numri i prokurimit: 632-23-636-5-1-1

Numri i brendshëm: 632-23-007-511

#### G. AUTORIZIM

Unë, i poshtë nënshkruari Bajram Rysa, drejtor ligjor dhe përfaqësues i „Eskavatori Company sh.p.k, me anë të kësaj letrë autorizoj z. Pjeter Qerimi, që të jetë përfaqësuesi dhe agjenti ynë ligjor që në emrin tonë dhe për interesin tonë të nënshkruaj të gjitha paramasat dhe parallogaritë, aplikacionet, marrëveshjet dhe të gjitha dokumentet e tjera të tilla, që mund të jenë të nevojshme për dorëzimin e tenderit të sipërpërmendur.

Çjithëshe për interesin tonë në përgjithësi të veprave përgjithërisht të gjitha fazave të tenderimit, duke përfshirë nënshkrimin e kontratës së sipër përmendur dhe pagosat.

Ky Autorizim i Përfaqësimit do të jetë i vlefshëm nga data e lëshimit dhe do të mbetet në fuqi deri në fund të projektit të sipër përmendur.

„Eskavatori Company“ sh.p.k.  
Bajram Rysa

Data: 17.05.2023



Me dt.31.05.2023, Company Eskavatori Sh.p.k.- lideri i konzorciumit NSHT “VIKTORY COM” Pjeter Qerimi B.I & Company Eskavatori Sh.p.k & Marisa Sh.p.k., në platformën e e-prokurimit ka ngarkuar një deklaratë ku deklaroi se nuk është pjesë e kërkesës për rishqyrtim për aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit”, Nr. i prokurimit- 632-23-636-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-007-521, prandaj kërkesa juaj për rishqyrtim nuk do të shqyrtohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

**Faton Gutaj**

  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës



**Eskavatori**

CONSTRUCTION COMPANY  
FERIZAJ, KOSOVË

Për:

Komunën e Gjakovës

Zyra Prokurimit

**SUBJEKTI: DEKLARATË**

Companya „Eskavatori” sh.p.k &, deklaron nën përgjegjësinë tonë të plotë morale dhe ligjore, se kompania „Eskavatori” nuk është pjesë e ankesës për rishqyrtim për aktivitetin e Prokurimit: **Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit**, numri i prokurimit: 632-23-636-5-1-1 që është dorëzuar në Komunën e Gjakovës.

Ferizaj:

31.05.2023



Companya „Eskavatori” sh.p.k  
Rruga Nacionale Ferizaj – Shkup, p.n. • 70000 • Ferizaj, RKS  
Mob 00383 49 100 504  
eskavatoricompany@gmail.com

## Xhelal Halilosmani

---

**From:** eprokurimi  
**Sent:** Wednesday, May 31, 2023 3:44 PM  
**To:** Xhelal Halilosmani  
**Subject:** Dokumenti për prokurimin "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit" / Document for the procurement "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit" / Dokumentat za postupak "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qa..."

I nderuar/ E nderuara

Operatori Ekonomik **Companya Eskavatori Sh.p.k.** ka derguar **Dokumenti për dërgim te AK** për procedurën **Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit** me date 31.5.2023 3:44:13 e pasdites.

Dokumentin keni mundësi të shkarkoni në sistemin elektronik të prokurimit publik të Kosovës. Pas kycjes në sistem, në menu Procedurat e prokurimit zgjedh Prokurimet e mia, zgjidh procedurën **Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë-Pjesë e qarkores së qytetit** dhe klikoni në butonat "Detajet" dhe "Dokumentet - Letrat Standarde".

Një kopje të këtij mesazhi ju mund ta gjeni në sistemin elektronik të prokurimit publik të Kosovës. Pas kycjes në sistem, në menyne MESAZHET zgjedh Mesazhet e mia.

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi kontaktoni shërbimin Help Desk.

Gjithë të mirat, KRPP  
Help Desk Service  
telefon (ditë pune): (038) 200 82 000  
e-mail: eprokurimi.helpdesk@rks-gov.net

---

Dear Sir/Madam,

Economic Operator **Companya Eskavatori Sh.p.k.** sent **Document for Contracting Authority** for procedure Construction of the exit road to Pejë-Part of the city circular on 31/05/2023 15:44:13.

Document can be viewed in electronic public procurement system of Kosovo. After log-in, in menu Procurement choose My procurements then select procedure Construction of the exit road to Pejë-Part of the city circular and click on buttons Details and Documents-Standard Letters.

You can find copy of this message in electronic public procurement system of Kosovo. After log-in, in menu MY NOTIFICATIONS select My inbox.

If you have any additional questions, please contact Help Desk Service.

---

Best regards, PPRC  
Help Desk Service  
telephone: (038) 200 82 000  
e-mail: eprokurimi.helpdesk@rks-gov.net

---

Poštovani(a),

Ekonomski operator **Companya Eskavatori Sh.p.k.** je poslao **Dokumenat za slanje UA** za postupak Izgradnja izlaznog puta za Pec´-Deo gradske kružnice na dan 31.5.2023. 15.44.13.

Dokumenat možete da preuzmete u sistemu elektronske javne nabavke Kosova. Nakon logiranja, u izborniku Postupci odaberite Moji postupci, odaberite proceduru Izgradnja izlaznog puta za Pec´-Deo gradske kružnice i kliknite na buton Detalji i Documenti-Standardne Pisme".

Kopiju ove poruke možete da pronađete u sistemu elektronske javne nabavke Kosova. Nakon prijave, u izborniku MOJA POŠTA odaberite Moje poruke.

Imate li dodatnih pitanja, obratite se Službi za korisnike.

Srdačan pozdrav, RKJN

Služba za korisnike

telefon: (038) 200 82 000

e-mail: [eprokurimi.helpdesk@rks-gov.net](mailto:eprokurimi.helpdesk@rks-gov.net)